

**RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
PËR
GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE, IMPIANTEVE
DHE INSTALIMEVE ELEKTRIKE**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i përgatitjes së projektligjit “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike” është realizimi i rolit rregullator të shtetit në fushën e sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

Duke pasur në konsideratë që shteti ka detyrimin të garantojë siguri për jetën e njerëzve, të kafshëve, mjedisit dhe pronës në tërësi ky projektligj synon të përcaktojë detyrimet e operatorëve ekonomik që kryejnë aktivitete që përfshijnë prodhimin, montimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, detyrimet të drejtat dhe kompetencat e strukturës përgjegjëse (inspektoratit shtetëror përkatës) si dhe trupave inspektuese palë të treta për inspektimin dhe vlerësimin e konformitetit të tyre duke përmirësuar kështu kuadrin ligjor dhe institucional.

Ky ligj ka për qëllim zëvendësimin e ligjit ekzistues Nr. 8734 datë 01.02.2001 me një ligj të ri në përputhje me kërkesat e ligjeve Nr. 10433/2011 dhe Nr.10489/2011, duke rritur kështu shkallën e sigurisë së punës së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

Drafti i ligjit në cilësinë e një *ligji të posaçëm* përcakton funksionin e inspektimit dhe trajton çështje mbi kërkesat themelore të sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

Ligji ekzistues nr. 8734 datë 01.02.2001 ka pësuar një sërë ndryshimesh qysh prej miratimit të tij në vitin 2001, disa prej të cilave me ndikime negative në zbatimin dhe interpretimin e kërkesave ligjore në fushën e sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, duke bërë kështu të pamundur përveç të tjerash edhe nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore. Miratimi i këtij projektligji do të plotësojë boshllëkun ligjor të krijuar dhe mundëson hartimin e akteve rregullatore teknike në zbatim të tij.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA
POLITIKE**

Projektligji “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike” rivlerëson fushën e veprimit, ku përveç kërkesave teknike që përfshijnë projektimin, montimin dhe shfrytëzimi i tyre dhe që mbikëqyren nga inspektorati shtetëror përgjegjës, specifikon më tej edhe kërkesat teknike për trupat inspektuese “palë e treta” që janë Organizma të Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK) në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” i ndryshuar, të cilat nga ana e tyre kryejnë vlerësim konformiteti për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike, duke lëshuar për to çertifikata inspektimi, raporte inspektimi dhe/ose raporte testimi duke bërë të mundur mbulimin kështu të një volumi shumë të madh pune inspektuese të cilin inspektorati shtetëror përgjegjës nuk mund dhe nuk duhet ta kryejë.

Sqarojmë ndërkohë se, implementimi i dispozitave në aspektin e treguesve të tyre teknikë dhe teknologjikë, bëhet nëpërmjet Rregullave Teknike të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Duke pasur parasysh se standardet shqiptare, bazuar në ligjin Nr. 9870 datë 4.2.2008 “Për standardizimin” i ndryshuar, i cili në nenin 7 pika 1 përcakton se “Zbatimi i standardeve shqiptare është vullnetar”, nga ana tjetër në pikën 5 të të njëjtit nen përcaktohet se “Ministritë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor, të cilat përgatisin rregulla teknike, që përmbajnë referime ndaj standardeve shqiptare ose pjesëve të këtyre standardeve, për zbatim në nivel kombëtar, bashkëpunojnë me DPS-në për mënyrën e referimit”, del e domosdoshme që në zbatim të ligjit (pas miratimit) të ndërmerren masa për hartimin rregullave teknike të nevojshme të cilat duke qënë se miratohen me VKM bëhen kështu të detyrueshme për zbatim së bashku me standardet e referuara.

Hartimi i këtij projektligji ka qënë një nga objektivat e MEI-t (sot MIE) gjatë vitit 2017 periudhë në të cilën është hartuar drafti fillestar i projektligjit, janë tërhequr mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet nga ministritë dhe institucionet e tjera dhe pas shqyrtimit të tyre është ripunuar drafti i projektligjit duke marrë në konsideratë një pjesë të konsiderueshme të tyre. Edhe për vitin 2018 hartimi i këtij projektligji është një objektiv i rëndësishëm i MIE-s, pasqyruar në matricën e objektivave të 300 ditëshit të parë të qeverisë.

Ky projektligj synon gjithashtu që përsa është e mundur (në cilësinë e ligjit të posaçëm), të pasqyrojë në mënyrë të qartë detyrimet e operatorëve ekonomikë që projektojnë, montojnë (instalojnë), mirëmbajnë dhe përdorin pajisje, impiante dhe instalime elektrike.

Në këtë projektligj është bërë dallimi midis produktit në tërësi dhe produktit elektrik të destinuar për përdorim në pajisje, impiante, instalime elektrike duke eliminuar kështu keqkuptimet e mundshme lidhur me produktet e destinuar për konsumatorin (për të cilin është dhënë edhe përkufizimi përkatës) dhe produktet e

destinuara për operatorë ekonomikë që montojnë (instalojnë) përdorin, mirëmbajnë dhe shfrytëzojnë pajisje, impiante, instalime elektrike.

III. ARGUMENTIMI I PRJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me miratimin e këtij projektakti do të garantohet realizimi i rolit rregullator të Shtetit për të garantuar sigurinë e jetës së njerëzve, të kafshëve, pronës e mjedisit, nga pasojat që mund të vijnë për shkak të aksidenteve nga aktiviteti në montimin, instalimin mirëmbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, duke garantuar kështu kërkesat thelbësore të sigurisë së përdorimit të tyre.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe nuk bie ndesh me kuadrin ligjor në fuqi.

Për formulimin e këtij projektligji janë marrë në konsideratë modeli i ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, tashmë në fuqi, në cilësinë e një ligji analog për fushën përkatëse, si dhe ligji italian Nr. 46/90 “Norme per la sicurezza degli impianti” i ndryshuar.

Ky projektligj nuk merr përsipër të përafrojë ndonjë direktivë të veçantë të BE-së sepse nuk ekzistojnë direktiva të tilla në fushën e sigurisë së pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrik të përfshira në fushën e këtij projektligji. Direktiva 2014/35/EU e Parlamentit dhe Këshillit Europian, e 26 shkurtit 2014, “Mbi harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me hedhjen në treg të pajisjeve elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit” është transpozuar në VKM 1061, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”” dhe ka të bëjë me pajisjet elektrike deri 1000 V a.c. dhe 1500 V d.c. të destinuara për “konsumatorin” sipas përcaktimit të dhënë në këtë projektligj, dhe jo me objektin e këtij projektligji.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike” në objektin e tij, përveç përcaktimit të “funksionit të inspektimit”, kërkesë kjo e nenit 11, pika 1 e ligjit Nr 10433 datë 16.6.2011 “Për

inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përcakton edhe kërkesa teknike të sferës së projektimit, montimit (instalimit), mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit për pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike, si edhe çështjet që kanë të bëjnë me kriteret dhe formën e realizimit të rolit rregullator të shtetit lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe inspektimin teknik të tyre në funksion të garantimit të sigurisë për jetën e njerëzve, të kafshëve, mjedisit dhe pronës, duke përcaktuar organizmat përkatës institucional në këtë fushë, detyrimet, të drejtat dhe kompetencat përkatëse.

Projektligji “*Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike*” është konceptuar i organizuar në VI Kre dhe në 26 nene.

Në **Kreun I**, paraqitet qëllimi, objekti dhe përkufizimet e termave të përdorura në këtë projektligj, ku neni 1 përcakton se “Qëllimi i këtij ligji është garantimi i sigurisë së punës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike në pronësi, administrim dhe/ose përdorim të operatorëve ekonomike privatë dhe/ose publikë, nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor dhe përcaktimit të kushteve të kërkesave thelbësore që duhet të përmbushen”. Në nenin 2 të projektligjit “Objekti” shprehen objekti i tij duke u bazuar në kufinj të tensionit për rrymë alternative (a.c) dhe rrymë të vazhduar (d.c.), ndërsa në nenin 3 jepen përkufizimet kryesore të termave të përdorura në projektligj.

Në **Kreun II** përcaktohen kërkesat për projektimin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, kushtet që duhet të plotesojnë subjektet që hartojnë projekte në këtë fushë dhe detyrimet që ato kanë lidhur me zbatimin e kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe rregullat teknike përkatëse.

Në **Kreun III** përcaktohen kërkesat që lidhen me montimin (instalimin) e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, kushtet që duhet të plotesojnë subjektet që kryejnë ato. Ky kre është mjaft i rëndësishëm pasi përcakton mjaft qartë detyrimet e operatorëve që kryejnë montimin (instalimin) e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, lëshimin e “deklaratës së konformitetit” për montimin (instalimin) e kryer dhe “deklaratës së përputhshmërisë” për rastet kur pajisja, impianti, instalimi është realizuar para hyrjes në fuqi të këtij projektligji duke i vënë kështu në pozita të barabarta ligjore si ato pajisje, impiante, instalime elektrike të montuara (instaluar) para hyrjes në fuqi të projektligjit, me ato të montuara (instaluar) pas hyrjes në fuqi të tij.

Njëkohësisht, ky kre (në nenin 7) përcakton kërkesat për regjistrimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike pranë Inspektoratit Shtetëror përkatës, kërkesë kjo që rrjedh prej ligjit 10489/2011, i cili përcakton se “*Personi përgjegjës i produktit/instalimit është, gjithashtu, i detyruar të regjistrojë produktin/instalimin dhe t’ia nënshtrojë atë inspektimit të rregullt periodik të kryer nga organet e miratuara kompetente për këtë qëllim*”, duke bere kështu të mundur krijimin e nje database mbi pajisjet, impiantet, instalimet elektrike në Republikën e Shqipërisë, e cila duhet përdorur për programimin e inspektimeve,

kërkesë kjo e ligjit 10433/2011, si dhe për organizimin e vlerësimit të konformitetit prej Organeve të miratuara të Vlerësimit të konformitetit, edhe kjo kërkesë e ligjit 10489/2011.

Në **Kreun IV** përcaktohen kërkesat që lidhen me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike të trajtura në tre nenet e para, ndërsa në nenin e katërt të këtij kreu është trajtuar këqyrja e aksidenteve dhe avarive të rënda.

Në **Kreun V** të projektligjit të përbërë nga tetë nene trajtohen në mënyrë të qartë e të plotë procesi i mbikëqyrjes, vlerësimit të konformitetit të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, përgjegjësinë e operatorit ekonomik nder të tjera detyrimin për t'ia nënshtruar pajisjet, impiantet, instalimet elektrike vlerësimit të konformitetit në afate periodike dhe në raste të veçanta.

Inspektimet e përmendura në këtë kre janë në përputhje me kuadrin ligjor mbi inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe mbi sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Njëkohësisht në këtë kre përcaktohen edhe të drejtat e inspektoratit shtetëror përgjegjës, për të patur akses ndaj mjediseve ku ndodhen në shfrytëzim (përdorim) pajisjet dhe instalimet elektrike, për kryerjen e inspektimeve përkatëse, sipas programit të inspektimit të miratuar nga ministri përgjegjës, si dhe rastet e veçanta siç janë rastet e aksidenteve dhe/ose avarive të rënda.

Në **Kreun VI** dhe i fundit të përbërë nga shtatë nene, përcaktohen kundërvajtjet administrative përfshirë rastin e përsëritjeve të shkeljeve prej operatoreve ekonomike, sanksionet e aplikueshme për çdo rast, si dhe detyrën e ministrisë përgjegjëse për energjinë elektrike për hartimin e rregullave teknike në fushën e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, në zbatim të këtij projektligji.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen ministria përgjegjëse për energjinë elektrike dhe inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT, SHPJEGIME NË LIDHJE ME IDENTIFIKIMIN E GRUPEVE TË INTERESIT, PJESËMARRËS NË KONSULTIM, KOHËZGJATJEN E PROCESIT TË KONSULTIMIT, ÇËSHTJET E DISKUTUARA DHE OPINIONET E SHPREHURA NGA GRUPET E INTERESIT, SI DHE REFLEKTIMIN OSE JO NË PROJEKTAKT TË OPINIONEVE TË GRUPEVE TË INTERESIT

Projektligji është hartuar nga një grup pune me përbërje të specialisteve të fushës të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe strukturave të varësisë.

Ky projektligj në muajin dhjetor 2016 iu është dërguar me shkresë për mendim ministrive të linjës dhe institucioneve të vartësisë të cilat janë shprehur lidhur me përmbajtjen e draftit të projektligjit.

Gjatë vitit 2017 projektligji është ripunuar nga grupi i punës, duke implementuar mendimet e administruara dhe është ridërguar për mendim, mendime të cilat në një masë të konsiderueshme janë pranuar dhe pasqyruar në draftin final të projektligjit.

Shpjegime të plota për sa më sipër janë paraqitur në “Raportin e Vlerësimit të Ndikimit” bashkëlidhur.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i propozuar nuk shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit.

MINISTRI

Damian Gjinkuri